

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi dhe anëtarët e trupit – gjyqtarët: Xheladin Osmani dhe Refki Piraj, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarve S. B. dhe L. E., për shkak se si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotike, supstancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.l. lidhur me nenin 31 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda, PP.nr.168/14 të datës 03.10.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tyre avokat H. C. dhe A. B., më datën 05.11.2015, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. S. B., nga i ati A. dhe e ëma S. – e lindur K., data e lindjes ... në Suharekë ku edhe tani jeton, e ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kamarijer, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej datës 14.06.2014 gjerë më 24.07.2014.

II. L. E., me nofkën “L.”, nga i ati M. dhe e ëma Y., e lindur K., data e lindjes ... në Suharekë, ku edhe tani jeton, e ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej datës 14.06.2014 gjerë më 24.07.2014.

JANË FAJTOR

Se më datën 14.06.2014 rrethë orës 15:00, në pikën kufitare të Vërmicës gjatë kontrollit të automjetit të markës “Audi A4” me tabela të regjistrimit xx-xxx-xx të cilën e drejtonte dëshmitari A. E., nga ana e policisë në ulësen e përparme nga ana e pasagjerit janë gjetur dy paketime dhe nën ulësen e vozitësit është gjetur një paketim, gjithësejtë tri paketime në sasi të përgjithëshme prej 3.267 kg. të supstancave narkotike të llojit “marihuanë” të cilat supstanca narkotike të akuzuarit B. K., L. E. dhe S. B. së bashku e kishin blerë në Ksamil të Republikës së Shqipërisë, nga një person i panjohur nga Lazarati e me qëllim të shitjes apo ofrimit për shitje

dhe shpërndarje, supstancë kjo e ndaluar sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor.

Këso dore si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 2, 4, 7, 17, 41, 45, 46, 62, lidhur me nenin 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KP i

G J Y K O N

Me dënim me gjobë secilin prej tyre në shumën **me nga 500 Euro** si dhe me dënim me burgim secilin prej tyre në kohëzgjatje prej 2 /dy/ viteve, në të cilin dënim me burgim do të iu llogaritet edhe **koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.06.2014 deri më 24.07.2014 - 41 ditë.**

Poqese dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrë të dhunëshme atëherë i njëjti dënim do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 Euro të dënimit me gjobë do të iu caktohet një ditë burg.

Nga të akuzuarit konfiskohet sasia e supstancës narkotike e llojit "marihuanë" në sasi të përgjithëshme prej 3.267 kg. si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të akuzuarit që secili prej tyre në emër të paushalit gjyqësor të paguaj shumën me nga 200 Euro, afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.168/14 të datës 03.10.2014, kundër të akuzuarve B. K., S. B. dhe L. E. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge e kryer në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KP.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 05.11.2015 është bërë veçimi i procedurës për të akuzuarin B. K. pasi që i njëjti është i paarritshëm – gjindet në Zvicërr dhe se gjykata për të njëjtin nuk ka adresë.

Në fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit Ervehe Gashi, ka deklaruar se nga provat e administruara dhe pjesërisht nga deklarata e vet të akuzuarëve është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë, se të akuzuarit janë takuar me një person

nga Lazarati dhe se pas ofrimit për shitje nga ana e këtij personi iu ka lindur ideja që të blejnë një sasi të “marihuanës”, ashtuqë të akuzuarit me vullnetin e tyre shkojnë në Lazarat, takohen me personin e panjohur nga Lazarati dhe nga ai blejnë sasinë e “marihuanës”, çdonjeri nga 1 kg. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale kanë dijtur për veprimet e njeri-tjetrit dhe janë pajtuar me pasojat dhe veprimet e veta dhe të bashkëkryerësve të tjerë. Nga praktika gjyqësore zakonisht “marihuana” për nevoja personale nuk blehet në sasi aq të mëdha e as që posedohet në sasi aq të madhe. Kemi të bëjmë me një sasi të “marihuanës” mbi 3 kg. të fshehur dhe transportuar deri në Kosovë me qëllim të shitjes apo të shërndarjes. Kjo është vërtetuar nga provat nga vendi i ngjarjes ku me përpikëri janë treguar vendet ku kanë qenë të fshehura paketimet me “marihuanë” e që janë konfiskuar nga ana e policisë. Andaj, konsideron se në veprimet e të akuzuarëve qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 273 par.1. të KP për të cilat të akuzuarit janë përgjegjës në aspektin penal-juridik dhe ka propozuar dënimin e paraparë me ligj duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe randuese si dhe si dënim plotësues konfiskimin e supstancës narkotike si objekt i kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit S. B. avokatja H. C. ka deklaruar se pas administrimit të provave nuk janë vërtetuar faktet dhe nuk janë formuar elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës. Nga deklarata e këtu të bashkë akuzuarit dhe të akuzuarit S. B. janë vërtetuar faktet se këtu i akuzuari ditën kritike meqenëse ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë dhe pas kontaktit me një person meqenëse është edhe përdorues i drogës – i kësaj supstance narkotike e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme, pasi që edhe çmimi ka qenë i përshtatshëm që i njejt i nga ai person ta blejë sasinë e narkotikut për të cilën ngarkohet, e kjo sasi në asnjë mënyrë nuk është kundërshtuar nga i mbrojturi im por të njejtën ka pasur për qëllim që ta përdor vetëm për nevojat e veta personale. Kështuqë duke u bazuar në deklaratën e tij ka propozuar trupit gjykues që lidhur me këtë çështje penale janë formuar elementet e veprës penale të paraparë nga neni 275 par.1. i KP. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ka propozuar gjykatës ti merrë parasysh rrethanat lehtësuese, sjelljen e të akuzuarit para trupit gjykues, moshën e tij, gjendjen ekonomike, i njejt deri më tani nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale apo të ngjajshme, ndërsa për këtë vepër penale pendimin e tij dhe premtimin e tij para trupit gjykues që i njejt asnjëherë nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjajshme. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. E., avokat A. B. ka deklaruar se i akuzuari qëllimin dhe mbajtjen e kësaj supstance narkotike e ka pasur vetëm për nevojat e veta personale e jo për shitje. Andaj, i propozoi trupit gjykues që gjatë matjes, lartësisë dhe shqiptimit të dënimin ti ketë parasysh edhe këto rrethana lehtësuese, se është i moshës së re, është i gjendjes së varfër ekonomike, hera e parë që bie ndesh me ligjin, i premton gjykatës se nuk do të bie ndesh me ligjin, gjatë seancave gjyqësore ka qenë korrekt andaj, i propozoi gjykatës që të ia shqipton një dënim sa më të butë, sepse edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet efektshmëria e sanksioneve penale. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje gjatë procedurës së provave është bërë shiqimi në raportin e vendit të ngjarjes, në listen e dëshmitëve 2014-ZWV-033 të datës 14.06.2014 si dhe në fotodokumentacionin që gjendet

në shkresat e lëndës, është lexuar raporti i ekspertizës së Njesisë së shkencave ligjore – analiza kimike të Agjensisë së Kosovës për forenzik me nr. referues AKF-2014-2613/14-2233 të datës 23.08.2014, si dhe janë marrë në pyetje të akuzuarit S. B. dhe L. E.

Nga raporti i vendit të ngjarjes i datës 14.06.2014 vërtetohet se në pikën kufitare në Vërmicë gjatë kontrollit rutinor nga ana e Policisë kufitare në një automjet të tipit “Audi” me targa të regjistrimit xx –xxx -xx janë zbuluar tri paketime të supstancës narkotike ku supstanca narkotike ka qenë e paketuar dhe e mbështjellur me shirit ngjitës e vendosur nën karrikën e vozitësit të veturës së lartëcekur, një paketim i mbështjellur me shirit ngjitës me supstancë narkotike nën karrikën e pasagjerit të parë të veturës së lartëcekur dhe një paketim i mbështjellur me shirit ngjitës me supstancë narkotike e vendosur nën karrikën e pasagjerit të parë të veturës së lartëcekur, e që kjo poashtu vërtetohet edhe nga lista e dëshmimeve të konfiskuara ditën kritike.

Nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës vërehet pamja e pikës doganore në Vërmicë, automjeti “Audi” xx-xxx-xx ku janë zbuluar tri paketime me supstancë narkotike si dhe të dyshuarit vozitësi A. B. dhe këtu të akuzuarit S. B., L. E. dhe B. K.

Supstancës së konfiskuar të dyshuar për narkotik i është bërë testi fushor dhe ka rezultuar të jetë narkotikë i llojit marihuanë në peshë prej 3.267.4 gram.

Supstanca e konfiskuar e narkotikut është dërguar në ekspertizë laboratorike pranë Njesisë së shkencave ligjore – analizave kimike të Agjendisë së Kosovës për forenzikë dhe më datën 23.08.2014 është përpiluar edhe raporti me shkrim në bazë të së cilës nga ekspertët është vërtetuar se dëshmit e dorëzuara dëshmia # 1, përmban një qese plastike e mbyllur me supstancë bimore me ngjyrë të gjelbërt pesha neto 4.93, gram dëshmia # 2, një qese plastike e mbyllur që përmban supstancë bimore me ngjyrë të gjelbërt pesha neto 5.09 gram dhe dëshmia # 3, një qese plastike e mbyllur që përmban supstancë bimore me ngjyrë të gjelbërt pesha neto 5.30 gram dhe se ekzaminimi i supstancës bimore me ngjyrë të gjelbërt nga dëshmitë 1, 2, dhe 3, ka treguar se është prezent “kanabisi” – “marihuana” që përmban tetrahidrokarabinol (THC).

I akuzuari S. B. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në PSH në Prizren në procesverbalin Hp.nr.169/14 të datës 03.07.2014, duke cekur se sasia e drogës që është gjetur në automjet është 3.267 kgr, “marihuana” dhe se secili prej tyre – ai, i akuzuari B. K. dhe L. E. kanë patur nga një kilogram. Derisa kanë qenë të tretë në Ksamil në plazh ka ardhur një person nga Lazarati dhe iu ka ofruar për blerje „marihuanën“ dhe atë 100 Euro për një kg dhe pasi që menduan se është çmimi i lirë e kanë blerë. Blerja është realizuar në Lazarat pasi që të tretë kanë shkuar atje me personin në fjalë dhe se secili prej tyre ka dhënë nga 100 Euro B. dhe gjithsejtë shumën prej 300 Euro B. ia ka paguar personit. Poashtu, ka shtuar se ka qenë përdorues i “marihuanës”, në kohën kur e ka blerë “marihuanën” dhe përafërsisht ka konsumuar 5-6 cigare në ditë ku për një cigare ka përzier 2-3 gram “marihuanë”. Sasinë e “marihuanës” që e ka blerë – një kilogram që ka qenë pjesë e tij ka mundur që ta konsumoi ndoshta për një vit. Marihuanën e paketuar secili e ka lënë përpara këmbëve në veturë, vetëm A. nuk ka qenë në dijeni që në automjet përfundim karrikës së tij ka qenë një

kilogram “marihuanë” pasiqë fare nuk i kanë treguar se që të tretë kanë blerë “marihuanë”.

I akuzuari L. E. në mbrojtjen e tij poashtu ka ngelur në tërësi pranë deklarës së PSH në Prizren në procesverbalin Hp.nr.169/14 të datës 03.07.2014 dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “marihuanën” e ka blerë për qëllime personale pasiqë ka qenë përdorues dhe se rastësisht e kanë takuar në Ksamil një person nga Lazarati që iu ka propozuar blerjen e “marihuanës”. Në Lazarat kanë shkuar me veturën të cilën e kanë pasë prej Kosovës dhe e ka drejtuar B. dhe se për një kilogram “marihuanë” kanë paguar 100 Euro, ashtuqë të hollat prej 100 Euro secili ia ka dorëzuar B., ndërsa B. personit në Lazarat. Pasiqë ka qenë përdorues i “marihuanës” në ditë ka konsumuar 3-4 ndonjëherë edhe 5 cigare me “marihuanë” dhe se sasia e blerë e “marihuanës” prej një kilogram ndoshta do ti mjaftonte për një vit.

Në bazë të provave të lartëcekura pas vlerësimit të secilës prove një nga një dhe në lidhshmëri njera me tjetrën gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve S. B. dhe L. E. krijohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve supstancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.1. lidhur me nenin 31 të KP pasiqë më datën 14.06.2014 rreth orës 15:00, në pikën kufitare të Vërmicës gjatë kontrollit të automjetit të markës “Audi A4” me tabela të regjistrimit xx-xxx-xx të cilën e drejtonte dëshmitari A. E., nga ana e policisë në ulësen e përparme nga ana e pasagjerit janë gjetur dy paketime dhe nën ulësen e vozitësit është gjetur një paketim, gjithësejtë tri paketime në sasi të përgjithëshme prej 3.267 kgr të supstancave narkotike të llojit “marihuanë” të cilat supstanca narkotike të akuzuarit B. K., L. E. dhe S. B. së bashku e kishin blerë në Ksamil të Republikës së Shqipërisë, nga një person i panjohur nga Lazarati e me qëllim të shitjes apo ofrimit për shitje dhe shpërndarje, supstancë kjo e ndaluar sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor.

Këtë gjendje faktike gjykata kryesisht e ka vërtetuar nga provat materijale, sasia e supstancës narkotike të llojit “marihuanë” e konfiskuar gjatë kontrollimit të automjetit në pikën kufitare të Vërmicës, e cila sasi e narkotikut ka qenë e paketuar në tri paketime dhe e vendosur nën ulëse – karriga të automjetit, e cila sasi e narkotikut më pastaj është dërguar në ekzaminim në Njësinë e shkencave ligjore dhe analiza kimike me ç rast edhe ka rezultuar se mostrat e dërguara në ekzaminim përmbajnë kanabis “marihuanë” që përmban tetrahidrokarabinol (THC).

Kjo gjendje faktike përpos provave materijale është vërtetuar edhe pjesërisht nga deklarata – mbrojtja e të akuzuarëve të cilët nuk e kanë mohuar faktin se në Lazarat nga një person i panjohur nga Shqipëria secili prej tyre – B. K., S. B. dhe L. E. kanë blerë nga një kilogram të supstancës narkotike të llojit “marihuanë” duke paguar 100 Euro për një kilogram. Supstancat narkotike të gjetura sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor, bëjnë pjesë në listën e supstancave psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinar, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë. Asnjëri prej të akuzuarëve nuk e ka mohuar faktin se kanë blerë këtë sasi të drogës. Mirëpo, të

akuzuarit e mohuan faktin se këtë drogë ta kenë blerë me qëllim të shitjes apo të furnizimit të personave të tjerë, sepse janë përdorues të drogës dhe se këtë sasi e kanë marrë me qëllim të përdorimit për vehte.

Pohimet e këtilla të akuzuarve S. B. dhe L. E. se sasinë e blerë të “marihuanës”, e kanë patur për qëllime personale – konsum personal pasiqë të njejtit në atë kohë kanë qenë përdorues të supstancave narkotike, për gjykatën janë të papranueshme, pasiqë sipas vet deklaratës së të akuzuarëve sasia e blerë e narkotikut-një kilogram, secilit prej tyre do ti mjaftonte për konsum për një vit. Andaj, është e palogjikëshme dhe e papranueshme për gjykatën që të blehet sasia e narkotikut për një vit dhe se mbrojtja e këtillë e të akuzuarëve është vetëm për të iu shmangur përgjegjësis penale pasi që në realitet është bindja e gjykatës se qëllimi i tyre ka qenë shitja dhe shpërndarja e supstancave narkotike në Kosovë.

Andaj, duke marrë parasysh të lartëcekurat gjykata edhe ka gjetur se të akuzuarit janë fajtor për veprën penale të lartëcekur, për çka edhe të njejtit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasiqë paraprakisht vërtetoi se të akuzuarit janë penalo-juridikisht përgjegjës.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata ka marrë parasysh nenin 41 të KPP,i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në rastin konkret dhe se prej rrethanave lehtësuese gjykata ka marrë parasysh moshën e re,gjendjen e varfër ekonomike,faktin se është hera e parë që bien në kundërshtim me ligjin. Ndërsa prej rrethanave rënduese motivet nga të cilat është kryer vepra penale-motivi është përfitimi materijal,si dhe intenzitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që kemi të bëjmë me supstanca me rrezikshmëri të lartë veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë. Pastaj faktin se veprën penale e kanë kryer me dashje,duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e së njëjtës dhe rrezikshmërinë e saj për rininë,pasiqë përdorues kryesisht është rinia dhe se droga shkatëron familjen, shëmton vetëdijen, degjeneron individin dhe viktimizon brezin e ri. Andaj, duke marrë parasysh këto fakte gjykata është e mendimit se me një dënim të këtillë të shqiptuar si në dispozitiv do të mund të arrihet qëllimi i dënimin i paraparë me nenin 41 të KP që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij,të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale,ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit me qëllim të luftimit të këtyre dukurive të shëmtuara shoqërore në mënyrë që të ndalet hovi i zhvillimit të tyre të mëtutjeshëm.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi konfiskimin e sasisë së drogës është marrë konformë nenit 62 par.2.p.2.6. të KP në lidhje me nenin 39.1 të Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe prekursor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 453 par.1 të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
Më datë 05.11.2015.P.nr.209/14

Procesmbajtësja
Sheqere Braha

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve,nga dita e pranimi,Gjykatës së Apelit në Prishtinë,nëpërmjet kësaj gjykata.